



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:233429

Datë: 15.02.2024

Numri i dokumentit: 05334086

C.nr.412/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni civil, Gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike të paditësit D.I nga Presheva, kundër të paditues M.I nga Vushtrria lidhur me ndarje fizike, jashtë seance, me datën 15.02.2024, e mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. PËRFUNDOHET procedura kontestimore në këtë çështje juridike.

II. Pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, procedura do të vazhdojë të zhvillohet sipas rregullave të procedurës jo kontestimore, pranë kësaj gjykate, respektivisht do të vazhdojë të shqyrtohet si propozim i propozuesit D.I nga Presheva, ndaj kundërpropozueses M.I nga Vushtrria, lidhur me ndarje fizike.

**A r s y e t i m**

Pranë kësaj gjykate me datën 12.09.2018 paditësi ka paraqitë padi për ndarje fizike.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë së paditësit, e në bazë të nenit 21 par 1 të LPK-së ku parashihet se: “Deri sa të merret vendimi mbi çështjen kryesore gjykata me anë të aktvendimit do ta përfundojë procedurën kontestimore, në qoftë se konstaton se procedura do të duhej të zhvillohej sipas rregullave të procedurës jokontestimore. Pasi të bëhet i formës së prerë aktvendimi në fjalë, procedura do të vazhdojë të zhvillohet sipas rregullave të procedurës jokontestimore në gjykatën kompetente”, konstatoi se procedura në rastin konkret do të duhej të zhvillohej sipas rregullave të procedurës jo kontestimore.

Andaj në bazë të nenit 21 par 1 dhe nenit 142 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm -Divizioni civil

C.nr.412/2018, datë: 15.02.2024

**GJYQTARI**  
Izet Gërguri

**KËSHILL JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditë nga dita e marrjes Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.